**RREGULLORE**
**Nr.7, datë 23.3.2005**

# MBI PËRMBAJTJEN E PROGRAMIT TË RISIGURIMIT TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT DHE AFATET KOHORE TË PARAQITJES PRANË AUTORITETIT

Në mbështetje të shkronjës i të nenit 14 të ligjit nr.9268, datë 29.7.2004 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve" dhe pikës 6 të nenit 108 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime", Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve nxjerr këtë rregullore.

## Neni 1
## Objekti

Kjo rregullore ka për objekt të përcaktojë rregullat bazë për hartimin e programit të nevojave për risigurim për çdo vit financiar të shoqërisë së sigurimit.

## Neni 2
## Tipet e marrëveshjeve të risigurimit që përfshihen në programin e sigurimit

Programet e risigurimit të lejueshme nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve duhet të jenë të njërës nga format apo kombinime të formave të mëposhtme:

a) Risigurim automatik: Kjo është një kontratë risigurimi që lejon cedimin automatik të klasave dhe shumave të rrezikut të parapërcaktuara, sipas termave dhe kushteve të specifikuara në marrëveshjen e risigurimit.

b) Risigurim fakultativ: Kjo është një kontratë risigurimi, e cila i lejon një shoqërie ceduese të bëjë risigurimin e rreziqeve specifike, kur kushtet dhe termat janë ofruar nga shoqëria ceduese dhe janë pranuar nga risiguruesi.

c) Risigurimi proporcional: Risiguruesi merr pjesë në pagesat e dëmeve dhe shpenzimet për humbjet sipas një raporti (proporcioni) të dalë nga pjesa që ai është përgjegjës nga shuma origjinale e rrezikut. Primet gjithashtu janë të ndara në raport sipas raportit të shumës së rrezikut të risiguruar.

d) Risigurimi joproporcional : Kjo marrëveshje mund të jetë në formën e mbulimit "excess *of loss*" ose "*stop loss*" ose një kombinim i të dyve. Përgjegjësia e risiguruesit fillon në momentin që humbja e lindur nga një rrezik i risiguruar arrin një shumë të përcaktuar. Kjo kontratë risigurimi mund të aplikohet në ndodhjen e një humbjeje që rrjedh nga një rrezik apo ngjarje e vetme, ose sipas një limiti total humbjesh duke mbuluar një klasë sigurimesh apo ngjarjesh, ose edhe një kombinim i tyre.

e) Tipe të tjera të zbatueshme.

## Neni 3
## Përmbajtja e programit të risigurimit

Çdo shoqëri sigurimi detyrohet të zbatojë një program risigurimi për çdo vit financiar.

Programi i risigurimeve përmban:

a) tabelën e mbulimeve maksimale të shoqërisë për çdo klasë sigurimi; Kjo tabelë hartohet në bazë të kapitalit të shoqërisë, provigjoneve statutore dhe primeve për çdo klasë;

b) procedurat, bazat dhe kriteret e përcaktimit të probabilitetit më të lartë të humbjeve në lidhje me rreziqet e marra në sigurim;

c) nivelin e mbulimit në risigurim të rënë dakord paraprakisht.

Neni 4

**Depozitimi i programeve të risigurimit në Autoritetin Mbikëqyrës të Sigurimeve**

Programet e risigurimit paraqiten pranë Autoritetit jo më vonë se 60 ditë kalendarike nga fillimi i vitit të ri financiar.

Pranë Autoritetit paraqiten edhe ndryshime të mëdha që u bëhen programeve të risigurimit ,siç janë ndryshimi apo shtimi i partnerëve të risigurimit apo ndryshimi i natyrës dhe i llojit të mbulimit të risigurimit.

Autoriteti shprehet brenda 45 ditëve nga data e depozitimit të tyre.

Shoqëria që aplikon për marrje të licencës për ushtrim aktiviteti sigurimesh ose risigurimesh, paraqet së bashku me dokumentacionin e kërkuar nga ligji nr.9267, datë 29.7.2004 edhe programin e risigurimit për veprimtarinë e parashikuar në planin e biznesit.

Neni 5

**Përshtatshmëria e programit të risigurimit**

Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve shprehet mbi përshtatshmërinë e programit të risigurimit kur:

a) transaksionet e risigurimit përfshijnë vetëm ato lloj transaksionesh të cilat përfshijnë transferim të përcaktuar të rrezikut;

b) programi i risigurimit është i përshtatshëm për nivelin e kapitalit të shoqërisë ceduese, profilin e rreziqeve të marra në sigurim, si dhe politikën e shoqërisë mbi mbajtjen e rrezikut me limitet e mbajtjes së lejuar të shoqërisë të përshkruara në këtë rregullore;

c) niveli i kapitalit dhe aftësisë paguese të shoqërisë janë të përshtatshme që të sigurojnë stabilitetin e vazhdueshëm financiar në lidhje me standardet e veta të mbajtjes së rrezikut;

d) mbrojtja e ofruar nga risiguruesi është e sigurt dhe i përmbahet kërkesave të vendosura nga kjo rregullore;

e) risiguruesi është një kompani e licencuar apo një kompani që njihet si e tillë nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve në pajtim me udhëzimin nr.15, datë 28.2.2005 të tij;

f) programi është në pajtim me kërkesa të tjera të tilla, të cilat Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve, mund t'i përshkruajë me akte të tjera nënligjore.

Neni 6

**Limiti i mbajtjes në sigurim nga shoqëritë e jo-jetës**

Duke iu nënshtruar limiteve specifike që aplikohen për kategori të caktuara të sigurimit të jo-jetës, të gjitha shoqërite e sigurimit të jo-jetës nuk duhet të marrin asnjë rrezik të vetëm apo të pranojnë risigurimin e ndonjë rreziku të vetëm, që rrjedh nga një rast i vetëm i sigurimit ku përgjegjësia e tij, sipas kësaj rregulloreje tejkalon dhjetë për qind (10%) të kapitalit të saj.

Neni 7

**Limite Specifike të mbajtjes në sigurim nga shoqëritë e jojetës**

Përgjegjësia e mbajtur në to nga risigurimi, sipas nenit 6 të kësaj rregulloreje, të një shoqërie sigurimi të jo-jetës për një rrezik të vetëm që rrjedh nga një rast i vetëm i siguruar në kategoritë e sigurimit të specifikuara më poshtë, iu nënshtrohet limiteve specifike si më poshtë vijon:

a) Sigurimi i kreditit – jo më shumë se dy për qind (2%) të kapitalit të shoqërisë;

b) Sigurimit i besueshmërisë (*fidelity insurance*) – jo më shumë se dy për qind (2%) të kapitalit të shoqërisë;

c) Sigurimit i garancive – jo më shumë se dy për qind (2%) të kapitalit të shoqërisë;

d) Sigurimi i garancive me hipoteka–jo më shumë se dy për qind (2%) të kapitalit të shoqërisë;

e) Sigurimi i depozitave–jo më shumë se dy për qind (2%) të kapitalit të shoqërisë;

Neni 8
**Limiti i mbajtjes në sigurim nga shoqëritë e jetës**

Të gjitha shoqëritë e sigurimit të jetës nuk duhet të ndërmarrin asnjë rrezik të veçantë apo të pranojnë risigurimin e rrezikut të vetëm të jetës që rrejdh nga një rast i vetëm i sigurimit ku përgjegjësia e tij sipas kësaj rregulloreje tejkalon dhjetë për qind (10%) të kapitalit të saj.

Neni 9
**Limite specifike të mbajtjes në sigurim nga shoqëritë e jetës**

Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve mund të vendosë limite specifike mbi mbajtjen e rrezikut të një shoqërie sigurimi të jetës për klasën apo klasat e sigurimit të jetës, nëse Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve e konsideron të arsyeshme, duke marrë parasysh madhësinë, shkallën dhe natyrën e biznesit të shoqërisë së sigurimt të jetës.

Neni 10
**Sanksione**

Për moszbatimin e kësaj rregulloreje aplikohen sanksione të parashikuara në ligjin nr.9267, datë 29.7.2004.

Kjo rregullore hyn në fuqi më 23.3.2005.

KRYETARE E KËSHILLIT
TË AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
**Burbuqe Riba**